

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	33,040,275	19,389,810
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	28,361,264	11,571,372
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6,27	30,553,812	30,280,390
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,679,774	6,546,360
Inventarë	8	24,677,685	6,449,672
Totali i aktiveve afatshkurtra		121,312,810	74,237,604
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	63,485,503	72,414,362
Totali i aktiveve afatgjata		63,485,503	72,414,362
Totali i aktiveve		184,798,313	146,651,966
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	56,916,409	-
Llogari të pagueshme tregtare	11	(20,165,601)	21,028,968
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12,27	36,826,434	36,826,434
Detyrime tatimore	13	2,209,836	665,940
Parapagime të arkëtuara	14	12,694,877	12,694,877
Të tjera detyrime	15	15,376,915	17,893,061
Totali i detyrimeve afatshkurtra		103,858,870	89,109,280
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme afatgjata nga palët e lidhura	16,27	1,528,925	1,528,925
Totali i detyrimeve afatgjata		1,528,925	1,528,925
Totali i detyrimeve		105,387,795	90,638,205
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		200,000	200,000
Rezerva ligjore		20,000	20,000
Fitime të mbartura		55,793,761	42,299,164
Fitimi i ushtrimit		23,396,757	13,494,597
Totali i kapitalit	17	79,410,518	56,013,761
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		184,798,313	146,651,966

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	121,825,398	91,496,350
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	12,022,175	8,397,971
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(65,617,137)	(45,722,501)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(47,636,584)	(31,220,433)
2) Të tjera shpenzime	21	(17,980,553)	(14,502,068)
Shpenzime të personelit	22	(24,726,022)	(24,458,235)
1) Paga dhe shpërblime		(22,845,229)	(22,745,534)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,880,793)	(1,712,701)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(14,736,562)	(12,992,036)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(5,000)	(42,256)
Shpenzime financiare	25	(1,234,310)	(794,075)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,100,758)	(311,773)
2) Shpenzime të tjera financiare		(133,552)	(482,302)
Fitimi/humbja para tatimit		27,528,542	15,885,218
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(4,131,785)	(2,390,621)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(4,131,785)	(2,390,621)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		23,396,757	13,494,597
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		23,396,757	13,494,597

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

T & C sh.p.k.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim /Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2018	200,000	20,000	3,100,623	39,198,541	3,320,623
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				13,494,597	13,494,597
Transferim në fitime të pashpërndara			39,198,541	(39,198,541)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	200,000	20,000	42,299,164	13,494,597	56,013,761
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				23,396,757	23,396,757
Transferim në fitime të pashpërndara			13,494,597	(13,494,597)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	200,000	20,000	55,793,761	23,396,757	79,410,518

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i T & C Sh.p.k. më _____, dhe janë firmosur si më poshtë:

Hartues i Pasqyrave financiare

Bledar Trebicka
Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	23,396,757	13,494,597
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime zhvleresimi	-	2,554,933
Shpenzime amortizimi	14,736,561	12,992,035
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata material	4,900,047	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(15,196,728)	10,265,528
Rënie/(rritje) në inventarë	(18,228,013)	123,175
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(39,650,673)	(6,956,846)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(2,516,146)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(32,558,195)	32,473,422
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(10,707,751)	(34,578,329)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(10,707,751)	(34,578,329)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	58,449,600	
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	(1,533,189)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	56,916,411	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	13,650,465	(2,104,907)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	19,389,810	21,494,717
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 33,040,275	19,389,810

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“T & C” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ne vitin 11.11.2009. në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare.

Shoqëria ka nipt K92326018D. Selia e shoqërisë është Rruga Nacionale Fushe Kruje - Vore, km 1, zona kadastrale nr. 1934, me numer pasurie 34/34, Durrës.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 kuota me vlerë nominale 2,000 LEK për një vlerë totale 200,000 LEK.

T & C Sh.p.k është një shoqëri shqiptare , e krijuar nga ortakët:

- C.O.M.A.R., që zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Trema Tech që zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Bledar Trebicka.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje, blerje, import-eksport të makinerive të ndërtimit dhe pjesëve të tyre të këmbimit.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 11 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2016 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2017.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2016.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapital.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete Monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	30,981,231	17,987,186
Në lekë	602,546	1,862,005
Në monedhë të huaj	30,378,685	16,125,181
Mjete monetare në arkë	2,059,044	1,402,624
Likuiditete në udhëtim	-	-
	<u>33,040,275</u>	<u>19,389,810</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	31,575,417	14,785,525
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(3,214,153)	(3,214,153)
	<u>28,361,264</u>	<u>11,571,372</u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim gjatë vitit 2019:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Gjendja më 1 Janar	3,214,1583	1,000,000
Rimarrje për vitin 2019	-	-
Zhvlerësimi për vitin 2019		2,214,153
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	<u>3,214,153</u>	<u>3,214,153</u>

6. Llogari të arketueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arketueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arketueshme nga Trema Tech	5,768,099	5,768,098
Të arketueshme nga Comar SAS	(594,781)	(601,843)
Të arketueshme nga Canzo BLB	6,659,967	7,414,107
Të arketueshme nga Trema Engineering 2	11,914,708	4,542,458
Të arketueshme nga T&C Kosovë	45,283	45,283
Të arketueshme nga ortakët	6,760,537	13,112,287
	<u>30,553,813</u>	<u>30,280,390</u>

7. Të tjera llogari të arketueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH e arketueshme	2,788,107	6,535,360
Garanci	11,000	11,000
TVSH Leasing	1,880,667	-
	<u>4,679,774</u>	<u>6,546,360</u>

8. Inventari

Inventarët më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra për rishitje	23,495,972	5,267,960
Lëndë e parë	1,181,713	1,181,730
	<u>24,677,685</u>	<u>6,449,693</u>

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri/Pajisje	Automjetet	Instrumente / vegla pune	Paisje Kompjuterike	Të Tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2018	47,333,785	18,684,950	2,611,906	1,140,238	111,032	69,881,911
Shtesa	23,421,271	9,245,516	1,292,400	619,142	-	34,578,329
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	2,554,933	-	-	-	2,554,933
Gjendja më 31 dhjetor 2018	70,755,056	25,375,533	3,904,306	1,759,380	111,032	101,905,307
Shtesa	5,855,340	4,616,285	-	236,126	-	10,707,751
Nxjerrje jashtë përdorimit	4,393,363	506,684	-	-	-	4,900,047
Gjendja më 31 dhjetor 2019	72,217,033	29,485,134	3,904,306	1,995,506	111,032	107,713,011
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2018	11,149,642	4,288,989	701,326	316,048	42,906	16,498,911
Amortizimi i vitit	8,692,764	3,470,936	542,703	247,594	38,084	12,992,036
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	19,842,406	7,759,925	1,244,029	563,597	80,990	29,490,947
Amortizimi i vitit	9,915,206	3,877,617	621,639	281,628	40,471	14,736,561
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	29,757,612	11,637,542	1,865,668	845,225	121,461	44,227,508
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2018	50,912,650	17,615,608	2,660,277	1,195,783	30,042	72,414,360
Gjendja më 31 dhjetor 2019	42,459,420	17,847,592	2,038,638	1,150,281	10,429	63,485,503

10. Hua afatshkurtër

Huatë afatshkurtëra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatshkurtër ABI Bank (OVD)	56,916,409	-
	<u>-</u>	<u>-</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare	20,165,601	21,028,968
	<u>20,165,601</u>	<u>21,028,968</u>

12. Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura

Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura paraqesin detyrimet më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj Comar SAS	-	-
Detyrime ndaj ortakeve	30,238,742	30,238,741
Detyrime ndaj Trema Tech	6,587,692	6,587,692
	<u>36,826,434</u>	<u>36,826,433</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	376,249	276,980
Tatim në burim	27,000	8,100
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	259,405	239,840
Tatim fitimi	1,547,182	5,115,462
	<u>2,209,836</u>	<u>5,640,382</u>

14. Parapagime të arkëtuara

Parapagime të arkëtuara paraqiten më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime të arkëtuara	12,694,877	12,694,877
	<u>12,694,877</u>	<u>12,694,877</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj punonjësve + Leasing RFZ	13,275,711	8,174,452
Detyrime të tjera	2,101,205	2,499,970
	<u>15,376,915</u>	<u>10,674,422</u>

16. Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme afatgjata ndaj palëve të lidhura paraqiten më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Te pagueshme ndaj Comar SAS	1,528,925	1,528,925
	<u>1,528,925</u>	<u>1,528,925</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 200,000 LEK i zotëruar 50% nga C.O.M.A.R Srl dhe 50% nga Trema Tech Sh.p.k.

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	2,000	2,000
Kapitali i nënshkruar	<u>200,000</u>	<u>200,000</u>

Shoqëria ka fitime të mbartura më 31 dhjetor 2019 në vlerën 55,793,761 Lek.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	90,618,511	58,808,796
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	31,206,887	32,687,554
	<u>121,825,398</u>	<u>91,496,350</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	133,640,955
Ndryshimi në parapagime të marra nga klientët	206,618
Faturime paraqitur si ulje shpenzimesh	-
Shuma e qarkullimit të korrigjuar	133,847,573
Sipas Kontabilitetit	133,847,573
Diferenca	<u>-</u>

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Te ardhura nga komisionet	8,600,370	5,783,873
Te ardhura nga rivleresimi/shitje e aktiveve	3,421,805	2,565,300
Te ardhura të tjera	-	48,798
	<u>12,022,175</u>	<u>8,397,971</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, materialeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Materiale të parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Mallra e aksesorë	46,624,180	30,002,393
Shpenzime për transportin	1,009,704	1,150,802
	47,636,584	31,153,195

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Blerje energji, avull, ujë karburant	298,221	776,368
Shpenzime qeraje	1,026,000	648,000
Mirëmbajtje dhe riparime	4,100,628	2,770,717
Sigurime	-	7,830
Shpenzime noteriale dhe financiare	657,888	250,211
Shpenzime udhetime e dieta	744,778	1,678,334
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	-	-
Pjese kembimi	3,713,755	2,844,082
Taksa të ndryshme	1,223,990	1,526,998
Shpenzime të tjera	6,217,993	4,066,766
	17,983,253	14,569,306

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	22,845,229	22,745,534
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,880,793	1,712,701
	24,726,022	24,458,235

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2019 është 11.

23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit përfshijnë shpenzimet e konsumit dhe amortizimit dhe provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14,736,562	12,992,036
Provizione për vitin	-	-
	<u>14,736,562</u>	<u>13,527,025</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjopa të ndryshme	5,000	42,256
	<u>5,000</u>	<u>42,256</u>

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për interesa	(1,100,758)	(312,048)
Të ardhura nga interesat	-	275
Humbje nga këmbimet valutore	(133,552)	(482,302)
Të ardhura nga këmbimet valutore	-	-
	<u>(1,234,310)</u>	<u>(794,075)</u>

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Fitimi para tatimit	27,528,542	15,885,218
Total shpenzime të panjohura	16,690	52,256
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	-	-
Shpenzime të tjera	16,690	52,256
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	27,545,232	15,937,474
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi @15%	4,131,785	2,390,621
	<u>23,396,757</u>	<u>13,494,597</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme		
Të arkëtueshme nga Trema Tech	5,768,099	5,768,098
Të arkëtueshme nga Comar Sas	-	-
Të arkëtueshme nga Canzo BLB	6,659,967	7,414,107
Të arkëtueshme nga Trema Engineering	11,914,708	4,542,458
Të arkëtueshme nga T&C Kosovë	45,283	45,283
Të arkëtueshme nga ortakët	6,760,537	13,112,287
	<u>31,148,594</u>	<u>30,882,233</u>
Detyrime		
Detyrime ndaj Comar SAS	594,781	601,843
Detyrime ndaj ortakëve	30,238,742	30,238,741
Detyrime ndaj Trema Tech	6,587,692	6,587,692
	<u>37,421,215</u>	<u>37,428,276</u>

**Për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2019**

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Shitje palëve të lidhura :

Trema Engineering 2

28,095,777

28,095,777

Blerje nga palët e lidhura:

COMAR SAS

256,452

BLEDAR TREBICKA

1,026,000

CANZO BLB

1,667,098

COMAR Commerciale

13,201,660

16,151,210

28. Angazhime dhe pasiguri

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërise nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.